



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA"  
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

**NJOFTIM PËR PUNËSIM**

Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Q.S.U "Nënë Tereza" kërkon të punësojë 1 (një) **Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse**, në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza".

**Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët janë:**

- Të ketë mbaruar Arsimin e Lartë, ne profilin Inxhinieri Elektrike/ Mekanike etj, në nivelin Master Shkencor. *Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;*
- Të ketë minimumi 5 (pesë) vjet eksperiencë pune, në fusha të ngjashme;
- Të njoh shumë mirë procedurat administrative;
- Të përmbushë në kohë dhe me korrektësi detyrat e ngarkuara;
- Aftësi për të përcaktuar objektivat, vendosur prioritete dhe respektuar afatet;
- Aftësi për planifikim buxhetesh si dhe në menaxhimin e stafit që drejton;
- Aftësi shumë të mira të punës në grup dhe fleksibilitet në pranimin e metodave dhe procedurave të reja;
- Aftësi të mira komunikimi.

**Për sa më sipër, personat e interesuar duhet të dorëzojnë:**

1. Kërkesa me shkrim e shoqëruar me fotokopje e dokumentit të identifikimit (ID)
2. Curriculum vitae (CV) (në gjuhën shqipe)
3. Diplomën/at e arsimit të lartë, të noterizuar/a
4. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë)
5. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore  
(<http://www.qsut.gov.al/rreth-nesh-8/te-punosh-me-ne/procedurat-e-marrjes-ne-pune-ne-qsut/>)
6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në CV dhe që lidhen me pozicionin për të cilin aplikon.

Depozitimi i aplikimeve do të bëhet pranë zyrës së Marrëdhënieve me Publikun në Drejtorinë e QSU "Nënë Tereza" duke nisur nga data **30.04.2021 ora 08:00 deri më 14.05.2021 ora 16:30.**

Komunikimi për datën dhe orën e Intervistave do të bëhet nëpërmjet **e-mail**-it në CV e kandidatëve.

Të gjithë kandidatët fitues do të rivlerësohen në fund të kontratës 3 (tre) mujore.

**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE**